




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-17163/22 datë:01.07.2022



Npi – 01/224 datë: 07.07.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 07.07.2022 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

I MBLEDHJES SË -VII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES  
E mbajtur më: 07.07.2022, (e enjte) në ora 9.<sup>00</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: Rrahman Jakupi, Përparim Ramusa, Lumni Amrushi, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Adelina Beqaj, Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu, Reshat Mujota, Asllan Beqaj, Shkurte Mustafa, Sanije Sadiki, (Heroina Selmani on-line), Kadri Emini, Muhamet Ademaj dhe Rexhep Gashi.

Në mbledhje përvèç anëtarëve të Kuverndit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtoret, Nga ZKF-ja z.Bujar Ferati; Nga Zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj, z.Shpëtim Gashi; Nga Radio Zëri i Shtimes, z.Muhamet Hoxha; Dhe znj.Valmira Hoxha, praktikante.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshtëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjafueshëm përmblajten e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**R E N D D I T E**

1. Pyetje - Përgjigje,
2. Propozim-Vendim përmbrëtje përmblajtja e destinimit të paluajtshmërisë Nr.1836-0, Z.K-Pjetërshticë,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës përmblajtja e Periudhës Janar – Qershor 2022,
4. Informatë nga DKA përmblajtja e Viti Shkollor, 2021/2022,
5. Informatë mbi raportin e performancës së Komunës, ( Shtyhet )
6. Informatë e përgjithshme nga KKSB-ja.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin përmblajtja e rendin e ditës, po sqaroj se sot përmblajtja nuk e kemi Ekstrakt-Procesverbalin përmblajtja e arsyeshme të shkurtë që kemi pas përmblajtja e rendit të Kuvendit, po ashtu propozoj që pikën e 5 të rendit të ditës ta shtyejmë. Në vazhdim hapi diskutimin përmblajtja e rendin e ditës.

**z.Përparim Ramusa;** Përshtëndetje, pajtohem me rendin e ditës, po ashtu pajtohem që pika e 5 e rendit të ditës të shtyhet.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi rendin e ditës, me vërejtjen që pika e 5 të hiqet nga rendi i ditës.**

Pika 1  
Pyetje Përgjigje

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Albana Podvorica;** Pyetje për DSHP-në, sa po ndërrmerrni masa për me e rregulluar çështjen e ujit të pajes dhe energjisë elektrike. sepse kohëve të fundit po kemi shumë problem?

**znj.Adelina Beqaj:** Pyetje për DSHP-në, qka po ndodhë te parku i pishave, që janë grumbulluar mbeturinat e nuk po mirëmbahet aty, çka po ndërrmerr drejtoria?

**z.Reshat Mujota:** Pyetje për DSHP-në, te menaxhimi i mbeturinave, çka po ndërrmerr Inspektorati, sa është aktiv në teren, sepse unë kam pa që nuk ka rrugë që nuk ka mbeturina. Te rruga e arave në Shtime, që përpara i kanë thane te bunari miles është bërë një deponi, pastaj te rruga “Islam Neziraj” në Mollopolc po ashtu është bërë një deponi, ku është vërejtë se aty po huden mbeturina edhe nga Shtimja por edhe nga Jezerci, unë po kërkoj që këto deponi sa më shpejt të eleminohen dhe të ndërrmerret diçka?

**z.Muhamed Ademaj:** Pyetje për DPUKGJ-në, sa është numri i objekteve të ndërtuara pa leje në pronat komunale, në qeveritë e kaluara?

**znj.Shkurte Mustafa:** Pyetje për DPUKGJ-në, kurë do të përfundojnë punimet te shtatorja e “Adem Jashari”? Pyetja e dytë për DPUKGJ-në, është, ka filluar asfalltimi i rrugës në lagjën Hysenaj, kur do të përfundojë ky projekt?

**z.Rexhep Gashi:** Pyetje për DPUKGJ-në, sa leje ndërtimi i ka lëshuar Komuna për persona fizik dhe sa për operatorë ekonomik?

**z.Besnik Seferi:** Pyetje për DPUKGJ-në, qka është duke u ndërrmarrë për rregullimin e rrugës “Tranzit” kur dihet mire se në atë rrugë jetojnë një numër i madh i banorëve të komunës tonë? Pyetje për DSHP-në, sa i përket ndriçimit kemi disa rrugë që mungon ndiqimi sikurse në rrugën “Ahmet Shtimja” rrugën në Qestën e Reçakut, në Lagjën e Pajtimit, në Godanc e në shumë fshatra a do të ndërrmirret diçka nga DSHP-ja që të ketë ndriçim?

Ne në Komitetin për Komunitete, kemi vizituar familjet e Komunitetit Rom dhe Ashkali në komunën tone dhe kemi hasur në familje që nuk kishte pasë energji elektrike që disa muaj, mua më ka shqetësuar ky fakt se si në këtë shekull një familje mos me pas energji elektrike që disa muaj, prandaj cila është mundësia që DSHP-ë të ndërrmarrë diqka në bashkëpunim me KEDS-in, cili është bashkpunimi me qëllim që të bëhet një zgjidhje?

Pyetje për DSHP-në, Komuna jonë i ka disa parqe, që janë të realizuara mirëpo mirëmbajtja e tyre është në nivel jo të duhur, cilët janë hapat konkrtet që këto parqe të jenë më të mirëmbajtura?

Sa i përket qështjes së mbeturinave, i përmendi zotri Mujota, mirëpo unë po pyes DSHP-në se sa ka qenë shqiptimi i gjobave për hudhjen e mbeturinave?

**z.Adem Ramadani:** Pyetje për DPUKGJ-në, pse nuk po asfaltohet rruga “15 Janarai”? Pyetja e dytë për DSHP-në, (pyetja nuk mund te kuptohet as nga Stenogrami).

**z.Hamëz Tërshani;** Pyetje për Kryetarin, a mund të na tregoni për aktivitetet e prokurimit me titull “Shërbimet e interpretimit dhe përfaqësimit të jashtëm ligjor në Komunën e Shtimes” vlera e parashikuar 8600€ (në vazhdim lexoi një tekst lidhur me Avokatë) shqetësimi është ky, çka po synoni me këtë, a nuk keni zyrtar të mjaftueshëm kompetent në komunën e Shtimes apo ka shumë lëndë, që duhet të angazhohet një avokat shtesë. Edhe thjeshtë prej kujt duhet ta mbron?

**z.Grejtalb Emini, Drejtor i DPUKGJ:** Përshëndetje, sa i përket pyetjes së Ademit, te rruga “15 Janari” ka disa prej banorëve që po hezitojnë dhe po pyesin për kyqje në Kanalizim, për shkak që po duhet me pas prerje të asfalltit për këtrë arsyë deri tash e kemi shty asfalltimin e rrugës 15 Janari? Sa i përket pyetjes së Shkurtes për projektin e shtatores së “Adem Jashari” besoj se pas festës së Kurban Bajramit do të përfundoj komplet ky projekt. Pyetjet tjera normalisht i merrni me shkrim.

**z.Adem Ramadani:** Pse ju si Komunë nuk po ju ndihmoni banorëve për me u kyqë aty me 3-4 metra çdo familje aty me një lidhje direkt për mos me pas pastaj prerje të asfalltit?

## Pika 2

Propozim-Vendim për ndrrimin e destinimit të paluajtshmërisë Nr.1836-0, Z.K-Pjetërshticë

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin për këtë pikë po e lexoi rekomandimin e KPF-së, në vazhdim fjalën ja dha Grejtalb Emini për prezantimin e kësaj pike.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Përshëndetje, duke marrë parasyshë rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe kërkesat e banorëve, ne si drejtori kemi propozuar për Kuvendin që në këtë parcelë përveq varrezave të definohet edhe një rrugë me gjerësi 6 metra, por duhet të sqaroj se kjo rrugë ndalet në një parcelë private, dhe nuk vazhdon më tutje, kështu që nëse ka kërkesa nga banorët e lagjës që kjo rrugë me u hapë, ne do ta shqyrtojmë mundësinë për hapjen e sajë, përndryshe tani për tani ajo është një rrugë qorre sipas dokumentacionit kadastral.

**z.Rexhep Gashi;** Kemi një kërkesë nga një banor për definimin e asaj parcele për varreza. Unë i falënderoj banorët që vullnetarisht i rregullojnë ato varreza. Unë kërkoj vetëm që të definohet mirë ajo rrugë prej 6 metrave.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Propozimi ynë është pra që në parcelën Nr.1836-0 të mbetet rruga prej 6 metrave gjerësi.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, Rekomandimi i KPF-së është që aty të mbetet rruga prej 6 metrave gjerësi, po u propozua nga drejtori edhe 5 metra unë mendoj se është e mjafqueshme, prandaj unë jam i mendimit se me këtë çështje nuk duhet me u bë politikë. Kuvendi nuk ka mundësi që të hap varreza për secilën lagje, sepse po krijojmë presedan edhe për raste tjera. Vendimi duhet të merret për gjith fshatin, dhe me vendim duhet të jetë e njofuar secila familje.

**z.Përparim Ramusa;** Rekomandimi i KPF-së ka qenë i arsyeshëm. Avni Dugolli nuk e përfaqëson krejt lagjën Dugolli sepse kjo lagje i kanë edhe dikund tjetër disa varreza. Kjo pra është vetëm për sa i përket familjarëve të asaj lagje të ngushtë të Avni Dugollit, që e ka bërë kërkesën. Unë mendoj se nëse e lëmë aty hapsirën edhe për rrugën prej 6 metrave, ata banorë aty do të kenë hapsira për varre edhe për 200 vjet. Unë propozoj që ta hudhni në votim rekomandimin e KPF-së.

**z.Lumni Amrushi;** Përshëndetje, kam obligim moral që edhe unë të them diçka për këto varreza meqenëse jam i ati fshati, dhe meqenëse e njoh mirë atë problematikë. Avnija ka bërë kërkesë, ndoshta është dashtë që me bërë kërkesë veq në drejtori për me e rregulluar atë lokacion, e jo edhe në Kuvend, por kërkesa ka ardhur dhe ne tash duhet ta shqyrtojmë. Kjo çështje nuk është diskutuar me banorët e lagjës. Këto nuk mundon me u quajtë varreza për lagjen Dugolli, sepse Avnija nuk e përfaqëson lagjen Dugolli, tani ne po vijmë para aktit të kryer. Nuk i kemi pa listat me nënshkrime.

**z.Idajet Rexhepi, Zyrtarë i Kuvendit;** Nëse dëshironi unë mund tua sjelli tani, Kërkesën e Avni Dugollit me nënshkrimet që janë në lista.

**z.Lumni Amrushi;** Unë jam "Për" por që të mbetet rruga prej 6 metrave gjerësi, dhe të dilet në teren për ta parë në vendin e ngjarjes dhe për ta definuar rrugën në këtë parcelë, e jo nga zyrja, le të mbetet rruga dhe vazhdojmë tutje.

**z.Reshat Mujota;** Unë po kërkoj para se të votojmë që ta di se përfar varreza po votojmë, a po votojmë për varreza të lagjes apo për varreza të familjarëve. Nuk është aspak etike për ne që të ndajmë parcela për varreza të familjarëve, prandaj unë propozoj që kjo të shtyhet dhe të sqarohet mirë nëse është parcel për varreza për krejt lagjen Dugolli.

**z.Besnik Seferi;** Nuk është praktikë e mirë që ne si Kuvend të ndajmë parcela për varreza të familjeve. Ne duhet me pas kujdes sepse është bërë një lloj peticioni, mirëpo nuk kemi argumenta të sakta se sa ky ka qenë në bashkëpunim me banorët e lagjes.

**z.Përparim Ramusa;** Për këtë parcelë është bërë kërkesa, kjo çështje është pjesë e ndieshme e punës tonë. Unë mendoj se rekomandimi i KPF-së duhet me u votuar.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Këtu ne po flasim vetëm për ndërrimin e destinimit të kësaj parcele, në këtë rast po vendosim që destinimi i sajë të jetë për varreza, e nuk po vendosim që këtë parcelë me ja dhanë dikujt në shfrytëzim. Avnija ka bërë kërkesë për shfrytëzim, mirëpo ne nuk mund të ja japim në shfrytëzim, sepse ajo është çështje dhe procedurë krejt tjetër. Ne po diskutojmë vetëm për ndrrimin e destinimit të kësaj parcele, për mua nuk është problem për 5-6 metra rrugë aty, nëse ju

vendosni ashtu. Momentalisht aty në atë parcel ka varreza, ndërkaq që në dokumentat kadastrale shkruan "kullosë" Nëse vendos Kuvendi atëherë do të ndryshohet destinimi nga "Kullosë" në "Varreza" dhe kaq.

**z.Reshat Mujota;** Flm. për sqarimin, nëse bëhet ndërrim destinimi atëher le të bëhet destinimi për varreza për komplet fshatin Pjetërshticë. Unë votoj për varreza për komplet fshatin vetem hudhe në votim, mirëpo nuk votoj për caktimin e varrezave për familje të caktuara.

**z.Muhamed Ademaj;** Edhe unë jamë që varrezat të jenë për tërë fshatin Pjetërshticë.

**z.Besnik Seferi;** Pajtohem me propozimin e Reshatit për komplet fshatin, kështu qysh e kemi në dijeni nga drejtoria.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Edhe unë pajtohem me ju që destinimi të precizohet, varreza për fshatin Pjetërshticë – Lagja Dugolli. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për ndrrimin e destinimit të paluajtshmërisë Nr.1836-0, Z.K-Pjetërshticë, për varreza të fshatit Pjetërshticë – Lagja Dugolli, me vërejtjen që në këtë parcelë me sipërfaqe prej 2882 metra katror (njëzet e tetë ari e tetëdhjetë e dy metra) të mbetet rruga e hapur me gjerësi 6 metra, ndërsa pjesa tjetër destinohet për varreza.**

### Pika 3

#### Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për Periudhën Janar – Qershor 2022

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, lexoi rekomandimin e KPF-së, në vazhdim fjalën ja dha Bujar Feratit për prezantimin e kësaj pike.

**z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Përvendosje, sot ne para jush po prezantojmë raportin financiar të Komunës për Periudhën Janar – Qershor 2022. Këtu po i pasqyrojmë shpenzimet e bëra gjatë kësaj periudhe, dhe po bëjmë krahasime me shpenzimet në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Shumat do ti prezantojmë ndaras sipas kodeve që janë bërë. Dokumentin e raportit e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, kështu që unë raportin do ta prezantoj në vijat kryesore, mirëpo nëse ka pyetje për ndonjë shpenzim të veqantë unë do të bëj përpjekje që ta spjegoj.

**z.Muhamed Ademaj;** Flm. për raportin, ky raport ofron informata të mjaftueshme për shpenzimet që janë bërë. Projektet kanë filluar të realizohen, është mirë që është shpenzuar sipas planifikimit, po ashtu është mirë që kemi rritje të të hyrave që i falenderojmë qytetarët.

**z.Përparim Ramusa;** Faleminderit për raportin, unë kisha dashur që ta kemi një pasqyrë me detale përsa i përket shpenzimeve te projekteve kapitale.

**z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Unë e lexova pjesën e shpenzimeve te kolona e 5 ku shkruan "aktuali" dhe më pastaj shkruan "pasuritë jo financiare" ku shuma është 139,521.38 kjo është pasqyrim nga huamarrja. Në vazhdim ky lexoi shifrat në detaje në dokument (shih dokumentin e raportit financiar).

**znj.Adelina Beqaj;** Faleminderit për raportin, unë po e përsëris edhe njëherë çështjen e huamarrjes. Komuna jonë ka marrë kredi 5 milion euro. Unë kérkojë ta di se ku janë ato 3 milion euro të shpenzuara.

**z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Në vitin 2019 kjo kredi është votuar në Kuvend. Rreth 1.782 milion janë shpenzuar deri tash, ndërsa për të tjerat unë nuk kam informacione të sakta, sepse këto informacione i kanë drejtoret përkatëse kështu që drejtoret mundë të përgjigjen më detaisht. Përonat e prekuara nga ndërtimi kolektorit ne duhet me marrë një raport nga kompania.

**znj.Adelina Beqaj;** Për marrëveshjen e Republikës e Kosovës me Austrinë, kryetari ka pas thënë se nuk janë 2 milion po 5 milion, ku janë edhe këto 3 milion tjera.

**Kryetari z.Qemajl Aliu;** Përvendosje, për ju dhe për të gjithë qytetarët, ju kisha lut që të fokusoheni te raporti financiar sepse këtu nuk jemi në fushat. Zyrtari financiar e sqaroi shumë mirë, por nëse është nevoja do ta saqarojë edhe më shumë, por edhe unë do ti ndihmojë nëse ka nevojë.

**z.Përparim Ramusa;** Vetëm 11.65% janë shpenzuar te projektet kapitale, pse janë shpenzuar kaq pakë, a e dini sa shpejt vjen dimri, pse nuk po filloni me projekte?

- z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Kolona e 5 që e përmenda ishte obligim i yni ndërsa kolona tjetër ishte zotim, në pritje janë 50 mijë euro, ndërsa pjesën e premtimeve e spjegon drejtori i DPUKGJ.
- z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Zotri Përparim ju e dini se dinamika e punëve është në muajin Korrik dhe Gusht. Në prokurim janë duke pritur projekte me vlerë mbi 300 mijë euro. Sa i përket shpenzimit unë ju sigurojë që i gjithë buxheti do të shpenzohet deri në fund të vitit.
- z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Ne jemi në proces të zhvillimit të projekteve dhe tanë në 6 mësuesit e parë e kemi për obligim me e aprovuar këtë raport. Do ta shihni se në raportin e 9 mësuesit shpenzimet kanë me qenë shumë më të larta.
- z.Përparim Ramusa;** Drejtori z.Grejtalb Emini po pretendon me fitu grantin e përfomancës me 11% të shpenzimeve, bëjeni njëherë një kalkulum.
- z.Lumni Amrushi;** Përvendetje, kamë bërë njëherë një pyetje për do punime në fshatin Pjetërshticë tash po besojë se ndoshta do të fillojnë punimet sepse për tu përfunduar në muajin Korrik ashtu qysh është thënë nuk ka mundësi.
- z.Besnik Seferi;** U tha nga parafolësit edhe përqindja e realizimit të projekteve. Unë po pyes se sa prej projekteve kapitale kanë qenë aneks projekte? Edhe në të kaluarën ka qenë kështu, realizimi i projekteve ka filluar në këtë periudhë. Unë mendojë se ky është një raport i cili duhet të kalojë.
- Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Raporti e ka një ndryshim të vogël të cilin do ta sinqerishtë zyrtari financiar dhe pastaj do ta hedhi në votim me ndryshim.
- z.Lumni Amrushi;** Unë po kërkojë një sinqerishtë për sa i përket ndarjes së subvencioneve në fushën e sportit, këtë po e them me qëllim që aty të mos figura zero. Unë po kërkojë që të kryhen subvencionet sepse krejt klubet janë duke e prit ndarjen e subvencioneve.
- z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Anekset e projekteve janë të pasqyrur te shpenzimet kapitale. Nërsa sa i përket spjegimit që u përkasin projekteve më së miri e din drejtoria e prokurimit.
- Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. \*Kuvendi i Komunës, me 19 vota “Për” me 1 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” e miratoi Raportin Financiar të Komunës për Periudhën Janar – Qershor 2022, me ndryshimet e prezantuar nga ZKF-ja.

#### Pika 4

##### Informatë nga DKA për Përfundimin e Vtit Shkollor, 2021/2022

- Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Lulzim Sahiti.
- z.Lulzim Sahiti, drejtori i DKA;** Përvendetje, fillimi i informatën e keni marrë të shkruar me kohë, mendoj, se e keni lexuar kështu që unë do të përmendi vetëm të dhënat kryesore. Në vazhdim lexojë informatën (shih dokumentin).
- z.Muhamed Ademaj;** Faleminderit për informatën. Unë të përgëzojë për informatën por edhe për punën dhe përkushtimin në drejtorinë e arsimit. Investimet në arsim duhen të rriten. E dijmë që në arsim ka probleme shumë siq janë mungesa e librave, mungesa e ujit e ngrohjes pastaj problemet e higjenës nyjet sanitare. Kisha dashur që stafin mos ta pranoni në vija partiakë ashtu sikurse ka ndodhur në të kaluarën.
- znj.Besartë Musliu-Spahija;** Unë kam një pyetje për sa i përket objektit të çerdhës “Albiona Asllani” se qka do të bëhet me këtë objekt dua një përgjigje konkrete sepse për këtë çështje kamë bërë pyetje edhe në mbledhjen e kaluar.
- z.Reshat Mujota;** Te organizimi i mësimit joformal me datën 27.12.2021 është nënshkrar një marrëveshje, pyetja është sa është numri i tutorëve komplet. Dhe a keni ndonjë informatë për ta?
- z.Kadri Emini;** Më lejoni ta përgëzoj dejtorin për një informatë të detajuar, sepse ka shumë kohë të gjatë që nuk kemi pasë një informatë kaq të detajuar edhe pse unë kamë qenë delegatë edhe në mandatet e tjera. Po ashtu e përgëzojë edhe për punën që është duke e bërë. Pyetja sa i përket nivelit të pastërtisë e di që nuk është më e mira, mirëpo është një shqtësim tjetër që puntorët teknik shpeshëherë nuk janë në vendin e tyre të punës, a keni ndërmarrë diçka lidhur me këta punëtorë?

**z.Pérparim Ramusa;** Kryetari i ka quajt drejtorat harambasha, a i konsideroni edhe ju drejtorat se janë harambasha.

**znj.Adelina Beqaj;** Faleminderit pér informatën e detajuar, pyetje e keni pa oborrin e çerdhes që nuk ka parking dhe a keni ndërmarrë diqka sepse aty është ngushtuar shumë hapësira. Pyetja tjetër a keni bërë diçka në drejtim të shkollave të reja që ka qenë premtim i juaji.

**znj.Albana Podvorica;** Përshëndetje, kam një kërkesë publike a e shikoni mundësinë pér me e hapë një çerdhe, po flas pér një çerdhe të re.

**z.Rahman Jakupi;** Fillimisht ju njoftojë se në vitin 2014/2017 është prezantuar ngjashëm një raport i tillë financiar kur kamë qenë unë kryesues. Unë e kisha quajt një raport të statistikave, mirëpo në këtë raport nuk ka diqka realiste. Kryetari e paraqiti si shpëtimtarë këtë drejtor, tash ky na qenka edhe shpëtimtarë i nxënësëve. Lind pyetja se tash pse po punësoni me Caritas, a është mirë me punësu me Caritas. Punësimet politike du me ia lënë kohës. Në oferten pér vizitë në Shqipëri kanë qenë tre ofertues a na tregoni pak më shmë pér këtë. Një kërkesë pér Athina Sylejmanin e cila 5 herë ka bë kërkesë a jeni përgjigjur. Mos ndërhy kur flas dhe mos na shit moral, se ç'do gjë është përfekte. Nuk është kjo informatë që u nevoitet anëtarëve të ri të Kuvendit. Po du me e kursy publikun por edhe juve se përndryshe keni qenë skandaloz.

**z.Hamëz Tërshani;** E falenderojë drejtorin pér një lexim, përfekt të raportit. E keni realizu një buxhet nga qeverisja e kalume. Pyetja por edhe shqetësimi im është se sa mësimdhënës kan mungu në mësim nëpër shkolla, dhe në kuadër të kësaj po më intereson se qysh është bërë notimi i nxënësëve.

**z.Rexhep Gashi;** Faleminderit pér informatën, unë të falenderojë pér punën dhe jo pér informatën. Në shkollën profesionale është një paralele e infermerisë, në vitin 2021/2022, mësimi në këtë paralele nuk është mbajtur pér mungesë të kuadrit, qka keni menduar pér këtë paralele, a do të bëhet prapë? Dy shkolla i keni pranuar teknikishtë, prej tyre shkolla e Gjyrkovcit është në gjendje të injerueshme.

**z.Besnik Seferi;** Faleminderit pér informatën, u bënë shumë pyetje e që disa prej tyre i kamë pas edhe unë. Një pyetje pér arsim, mendoj se në raport përvèç sukseseve është dashur të përmenden edhe sfidat, po lidhem te bursat pér student që është shpallur konkursi, por jo ashtu qysh kemi vendosur në Kuvend, pse? Qka është ndërmarrë pér transsportin e nxënësve në fshatrat e largëta? Ku jemi tash me pagesën e pagave jubilare? Shkolla verore a do të ketë ndonjë ndryshim? A është bërë shkolla profesionale me kamera vëzhgimi? A është planifikuar të hiqen stufat në shkollat amë, sepse aty po bëhet tym? A është krijuar një komision pér fëmijët pér nevoja të veqanta, dhe cilat kanë qenë kriteret pér pranimin e tyre?

**z.Gzim Haxhiu;** Faleminderit pér informatën, unë kam një kërkesë pér shkollën e fshatit Rashincë kërkesa është që gjuha frenge të zëvendësohet me atë gjermane?

**z.Asllan Beqaj;** Përshëndetje, unë po kërkojë një sçarim pér gjendjen në shkollat e tërsishme si p.sh në shkollën e fshatit Petrovë e cila është në gjendje të injerueshme a keni planifikuar ndryshimin e gjendjes?

**z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA;** Pyetjeve do tu përgjigjem me shkrim. Te bashkësia e 5 sa i përket çerdhes së fëmijëve do ta aktivizojmë, po sa të kemi mjete buxhetore. Ndërsa sa i përket Tutorëve i kemi të angazhuar 4 tutorë në qendrën mësimore në Gjyrkovic dhe në Vojnovc. Sa i përket punëtorëve teknik, përkatesishtë mungesës së tyre nga puna ne kemi bërë vizita në shkolla dhe nuk kemi hasë në mungesë të tyre në vendin e punës, nëse ka argument pér këtë ne do ti shqyrtojmë. Për sa i përket çerdhes "Albiona Asllani" ne do ti shikojmë mundësit pér sa i përket zgjerimit të parkingut aty, mirëpo prioritet është aktivizimi i sajë.

**z.Muhamed Ademaj;** Unë mendojë se ne duhet me bërë diqka pér paralelen e infermerisë, me qëllim që kjo paralele të mos shuhet.

**z.Pérparim Ramusa;** Kryetar, më shumë po ndihet mungesa ime se sa prezenca jote, mirëpo nuk u përgjigj drejtori në pyetjen time se a i konsideron drejtorat harambasha.

**z.Rahman Jakupi;** (Lexoi një pjesë të informattës lidhur me ndërrimin e hotelit të nxënësëve, në eksurzion në Shqipëri).

**z.Rexhep Gashi;** Ne e kemi një rregullore të punës së Kuvendit, pikërisht ti je ai që po e shkel këtë rregullore, ekzekutivi duhet me paraqit informatën për 5 minuta. Ka anëtarë të Kuvendit që e marrin fjalën nga 6-7 herë. Kjo nuk është tolerancë por është shkelje e rregullores.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pikërishtë duke e ditë këtë unë i thashë drejtorit për me e shkurtu prezantimin e informatës.

**z.Reshat Mujota;** Te kjo pikë nuk po e shkelim rregulloren, sepse drejtori nuk ma dha përgjigjen, mirëpo unë po pres që përgjigjen ta marrë me shkrim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Në të gjitha pyetjet për të cilat nuk keni marrë përgjigje ato do ti merrni me shkrim.

### Pika 5

#### Informatë e përgjithshme nga KKSBB-ja

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kryetarit z.Qemajl Aliu.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Përshëndetje, lidhur me raportin ju njoftoj se KKSBB-ja, ka mbajtur dy mbledhje. Raportin e keni pranuar me kohë në formë të shkruar. Në takimet që kemi pas në KKSBB kemi diskutuar shumë tema, kemi nxjerrë shumë konkluzione dhe mendime, kemi kërkuar bashkëpunim më të madh në të gjitha institucionet lokale, meqenëse tani po presim një mot më të ngrohtë, me theks të veçantë është diskutuar çështja e përhapjes së zjarreve në ambiente të hapura. Çështje tjetër me rëndësi kanë qenë diskutimet për aksidentet në trafik. Po ashtu kemi diskutuar për vërvshimet që kanë ndodhur dhe trajtimi i tyre. Në 6 muajrin dytë sigurisht që do të mbajmë mbledhje më shpesh sepse në këtë periudhë kemi filluar pak me vonesë. Nëse ka dikush ndonjë pyetje për raportin unë do të përgjigjem.

**z.Muhamet Ademaj;** Faleminderit për informatën, irritja e siguris është nevojë për qytetarët e Komunës, prandaj unë mendojë se është e nevojshme vendosja e kamerave të siguris në të gjithë qytetin por edhe në qendrat e fshatrave.

**z.Adem Ramadani;** Informata mu dok pak e shkurt, sa i përket zjarreve dhe vërvshimeve. Po lidhem te zjarrfiksat, mua po më intereson a ka rritje të stafit të zjarrfiksave, sepse nëse kemi rastin që na paraqiten dy ose më shume zjarre në të njejtën kohë nuk ka staf të mjaftueshëm që mundë ti mbulojë.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Pyetja është shumë me vend sepse vërtet jemi keq me numrin e zjarrfiksave, i kemi vetëm 8 zjarrfiksa ndërkaqë që sipas numrit të banorëve do të duhej ti kemi së paku 18 zjarrfiksa. Jemi në proces të bartjes së kompetencave te Ministria e Punëve të Brendshme. Ne kemi thënë se na duhen edhe së paku 3-4 puntorë, mirëpo siq e dini këtë vit sa i përket kësaj çështje nuk kemi buxhet.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoj në ora 11:49h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi